



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 10.09.2019

Handwritten signature and date: 10/09/2019

PROCESVERBAL

i mbledhjes së VII-të (shtatë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 04/115 e dt: 17.06.2019 e parashtruar nga drejtori i Drejtorisë Ekonomi, Financa dhe Buxhet për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Malishevës 2020-2022
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/203 e datës: 28.03.2019 e parashtruar nga Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të komunës
3. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/281 e dt: 17.06.2019 e parashtruar nga drejtori i Drejtorisë së Administratës për miratimin e Draft-Rregullores për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare në Komunën e Malishevës
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr. 01/526 e dt: 25.04.2019 për marrjen e vendimit për procedurë të mëtejme për caktimin e lokacionit për ndërtimin e “Pishinës Gjysmëolipike” në Komunën e Malishevës
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/1597 e dt: 06.11.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndërrimin e pronës publike me pronë private për interes publik me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Panorc, KK Malishevë
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit të Integritetit të Komunës së Malishevës për vitin 2018-2020
7. Shqyrtimi i kërkesës nr. 05/255 e dt: 06.06.2019 për iniciimin e procedurave për hartimin e hartës zonale të Komunës
8. Shqyrtimi i raportit të Drejtorisë për Bujqësi për mbjelljet pranverore për vitin 2019
9. Shqyrtimi i kërkesës nr. 02/347 e dt: 11.06.2019 për miratimin e Raportit për Performancë Komunale për vitin 2018
10. Shqyrtimi i Raportit për kompensimin e tri pagave përcjellëse sipas kërkesës së KPF-së dhe marrja e vendimit për kompensimin e tyre
11. Shqyrtimi i Raportit për Përgatitjen e Krrje-Shirjeve nga Drejtoria për Bujqësi
12. Përgatitjet për pritjen e bashkatdhetarëve të Komunës së Malishevës
13. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/303 e dt: 22.05.2019 e parashtruar nga Sindikata Komunale e arsimit Parauniversitar (SKAP) në Malishevë
14. Shqyrtimi i kërkesës nr. 02/305 e dt: 23.05.2019 e parashtruar nga përfaqësuesi i shoqiatës “Shën Tereza” dega në Malishevë

15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/53 e dt: 17.05.2019 e parashtruar nga z. Rexhep S. Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore
16. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/58 e dt: 27.05.2019 e parashtruar nga Z. Arsim S. Krasniqi nga fshati Tërpezë e Poshtme për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore
17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/59 e dt: 28.05.2019 e parashtruar nga Z. Faik Thaçi nga fshati Mirushë për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore
18. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/60 e dt: 29.05.2019 e parashtruar nga Z. Jetfir Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore
19. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/61 e dt: 29.05.2019 e parashtruar nga z. Fehmi Kryeziu nga fshati Bubavec për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore
20. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/62 e dt: 05.06.2019 e parashtruar nga z. Halit Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore
21. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/62 e dt: 20.06.2019 e parashtruar nga Z. Ali Feriz Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore
22. Të ndryshme

Mbledhja mbahet me datë 01.07.2019 dhe filloi në ora 10:39 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 22 asambleistë, Kryetari, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, LMT dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë të pranishmit. Po e hapi mbledhjen e VII të rregulltë të Kuvendit të Komunës së Malishevës. E hapi debatin jashtë rendit të ditës.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kryetar që dy mbledhje që i kemi mbajtur ti nuk ke qenë këtu dhe nuk e di a ti ka transmetuar kërkesat tona Nënkryetari. Është hera e 5-të që e ngriti çështjen për rrugën në hyrje të Malishevës nga Banja ku po rrezikohet çdo ditë jeta e pjesëmarrësve në trafik, është krijuar një moqal me ujë nga pjesa e djathtë, Kryetar është mirë që të merreni me këtë çështje.

Ne si grup ja kemi dorëzuar një kërkesë Drejtorisë së Kulturës që 1 muaj dhe ende ne nuk kemi marrur përgjigje.

Florentina Zulfaj: Pershendetje për të gjithë! Në fshatin Senik në lagjen “Zulfaj” ka problem me gypat e kanalizimit për shkak të kualitetit të dobët. Para 5 muajsh inspektorët kanë qenë në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë fotografi dhe matje por pa donjë rezultat. Dëmet nga ky problem janë të konsiderueshme sepse janë prona private. Kërkoj një përgjigje për këtë.

Nebih Bibaj: Pershendetje për të gjithë! Me buxhet i kemi nda disa metra kanalizim në Lladroc që të lidhet me shkollën vjetër në gypin kryesor, mirëpo aty asgjë nuk është bërë dhe kanalizimi është mbi tokë. Është mirë që të ndërmerret diçka para se të vije shtatori.

Kryetar, a do ta lëshoni shkollën për mësim në shtator? Kur do ta pajisni me inventar? A ka ujë në shkollë të të re sepse nuk ka? Me buxhet është paraparë edhe rregullimi i oborrit të shkollës dhe është mirë që të kryhet edhe kjo punë para shtatorit.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kërkesën e shoqitave të dalura nga lufta për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e zyreve do ta paraqes në çdo mbledhje edhe pse dy herë kemi bërë kërkesë me shkrim ne asnjëherë nuk kemi marrur përgjigje nga ju Kryetar.

Pasi që invalidi i luftës Zenel Thaçi ju është drejtuar disa herë me kërkesë Kryetar për ndihmë për një shtëpi ju nuk i keni kthyer përgjigje. Me një kërkesë të tillë për këtë rast ju ka drejtuar juve edhe shoqata e Invalidëve të Luftës dega në Malishevë.

Gjatë zgjedhjeve për kryetarë të fshatrave qytetarët po ankohen për punën e keqe që po bëhet në investime e sidomos për kanalizimet. Probleme me kanlizimet ka çdo fshat.

Alban Krasniqi: Kryetari është fajtor që klima nuk po punon, karrigat që ajnë të prishura dhe që nuk i kemi kushtet elementare të punës këtu prej kur e kemi marrur mandatin ne këtu dhe nuk kemi nevojë për përgjigje në folotër por për zgjidhjen e problemeve.

Me 23 maj 2019 si Komisioni i Aksionarëve ja kemi dërguar një leter Kryetarit dhe drejtorit të Urbanizmit ku kemi shprehur shqetësimin tonë për ndërtimin pa leje të Inkubatorit të Biznesit në Stacionin e Autobusëve dhe që të bëjmë një marrëveshje bashkëpunimi në mes Stacionit dhe Komunës. Kryetar nëse ti nuk ndërmerr masa që ta kthesh në gjendje ligjore ndërtimin, me marr leje dhe për të marrë leje je i obliguar të bësh marrëveshje me Stacionin e Autobusëve sepse je në tokën, objektin dhe pasurinë e Stacionit të Autobusëve. Nëse t'i nuk merr masa ne jemi të detyruar që këtë ta paraqesim në polici dhe gjykatë deri sa të bie në ligjshmërinë e domosdoshme.

Rrahim Morina: Kam biseduar për çështjen e klimës me drejtorin e Administratës ata kanë një kontratë për mirmbajtjen e klimave dhe shumë shpejt do të rregullohet edhe kjo çështje.

Çështja tjetër është për zyrtarët e Kuvendit që vijnë kur dojnë në punë dhe kur dojnë dalin nga puna. Sot Marigona nuk vjen këtu sepse thotë “nuk du me ardh” atë e ka mësu kështu Kryetari sepse ai thotë që: “mos shko në Komisionin e Aksionarëve”. Unë do t'i filloj masat ligjore për këtë çështje.

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kam një çështje për ndriçimin publik. Kryetar deri te ne është bërë ndriçimi publik por jo deri te ferma dhe si ka ndodhur kjo unë nuk e di sepse po akuzohem që jam këshilltare në Asamble ka ardhur ndriçimi deri tek unë. Kur të bëhet Korinizës Buxhetore duhet të hyjë ajo pjesa e ndriçimit publik dhe totuari i rrugës sonë.

Sadije Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Edhe përkundër investimeve të shumta që janë bërë në kanalizime dhe ujësjellës duket që ende ka nevojë që në disa fshatra që bëhen investime në këto dy kategori. Në Drenoc ka shqetësime për mosfurnizimin e rregullt me ujë të pishëm sidomos verës edhe përkundër ankave të qytetarëve. Drejtor ju kisha lut që të kontaktoni me Hidroregjionin që qytetarët tanë të kenë ujë të pishëm.

Hamëz Bytyqi: Pershendetje për të gjithë! Kam një pyetje për Kryetarin. Shkoza a i përketë Malishevës apo Rahovecit? E keni bërë një projekt të vogël për Shkozë, por e keni devijuar projektin dhe e keni çuar kah shtëpitë e juaja.

Në rrugën “Sali Bytyqi” pas vërshimeve askush nuk u intersua për të. Jam detyruar vet me rregullu atë rrugë. Shkozën gjithëmonë e ndani përgjysmë, projektet vijnë veç deri te shkolla po harroni se edhe përtej shkollës ka banorë në fshat. Nga lagja “Sali Bytyqi” janë 4 dëshmorë por asnjë cent nuk është investuar aty.

Ali Morina: Pershendetje për të gjithë! Shqetësuese ka qenë për mua organizimi i Ditës së Çlirimit ku ekzekutivi ka qenë i shpërputhur. E nderuara drejtoreshë, nuk e keni paraparë që në seancën solemne që është mbajtur në Shtëpinë e Kulturës personat kompetentë për orjetimin e musafirëve se ku të ulen e jo militantët e NISMA të t'i orjetojnë musafirët. Kur kemi bërë homazhe te shtatorja e “Adem Jasharit” i kemi bërë mbrapa shtatores për arsye të moskoordinimit të Drejtorisë me ata personat që kanë pasur për të vendosur binën. Shqetësimi tjetër lidhet me ftesat për familjet e dëshmorëve dhe pjesëmarrësve tjerë nuk e keni cek se ku ka qenë e paraparë dreka të mbahet e jo të ftohen njerzit vesh më vesh veç kë keni dashur ta ftoni. Me 16 qershor është bërë prorurimi i memorialit të Masakrës së Burimit, por nuk i keni ftuar anëtarët e familjes së të vrarve në atë ditë e as ma keq nuk i keni ftuar as të perjetuarit e asaj masakre. Kërkoj që në ditë të tilla të keni një kujdes më të veçantë dhe të jeni më bashkëpunues në mes vete.

Rajmonda Krasniqi: Kërkesën për shpërblimin e OJQ-ve me para ne e kemi bërë me 24 maj dhe është bërë 1 muaj që s'kemi marr përgjigje. Drejtoresha tha që 10 ditë e kemi bërë gati përgjigjen dhe e kemi dërguar. Kush na përgjigjet se ku e kanë dërguar? Pse ne nuk e kemi marrur?

Është një kërkesë e lagjes “Hysenaj” e bërë me shumë se 1 muaj për Kryetarin e Komunës për vendosjen e policëve të shtrirë për shkak të shumë aksidenteve dhe rrezikshmërisë që kanë qytetarët në rrugën “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”. A do të ndërmerri diçka Kryetar? Nëse jo Kryetar ata do të ndërmarrin vet ndonjë aktivitet për këtë çështje.

Një projekt ka nisur për palestër në oborrin e shkollës “Ibrahim Mazreku”. Gjersia është 18m dhe prej ekspertëve të shkencave sportive kam një kërkesë se pse të mos jetë minimumi 20m sepse ka hapësirë mbrenda oborrit të shkollës?

Kryetar, si është e mundur që të gjitha tenderët në K. e Malishevës i marrin ata që kanë qenë donatorë në fushatë për NISMA. Pavarsisht kush e mbështet një subjekt politikë kjo është para e qytetarëve jo e subjekteve politike.

Arlind Morina: Pershendetje për të gjithë! Shqetësuese për banorët e Astrazupit është ndriçimi publik sepse rrebeshi i shiut dhe bubullimat e mëdha e kanë dëmtuar një pjesë të ndriçimit në rrugën “Rilindja Kombëtare”. Gjitaashtu është dëmtuar edhe rruga “Qarri” sepse është mbartur zhavori. Gjithashtu në dy vende është bllokuar edhe rruga kryesore për këtë edhe e kam telefonuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Hashim Vrenezi: Pershendetje për të gjithë! Kryetar, a jeni duke e monitoruar Planin e Prokurimit të cilin e keni bërë vet dhe aty janë disa data ku palnifikohet të përfundojnë projektet. Pse nuk po kryhen projektet sipas atyre datave të Planit të Prokurimit? Pse s'po monitorohet ky plan nga ana e juaj?

Ka projektet të cilat nuk janë në buxhet e as në Plan të Prokurimit e të cilat nëpër disa vende punohet dhe nuk e di se nga po i merrni ato fonde që po i kryeni ato punime. Kjo nënkupton që ju po tentoni që të bëni devijime të buxhetit dhe të Planit të Prokurimit të cilin neve na keni sjellë veç sa për sy e faqe. Në qoftëse vazhdoni në këtë formë ne jemi të obliguar që të fillojmë me procedurat gjyqësore për devijimin e projekteve.

Shqetësese është ndarja e bursave dhe keni bërë reklamë politike. Më e ultë se kjo është. Se me cilat kritetere i për zgjidhni nxënësit nëpër disa fshatra që ju paguani rrugën dhe ato pare ja jepni kesh. Cilat janë ato kritere? Këtu jeni duke e shkelur ligjin.

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Të gjithë kanë të drejtë t'i shprehin shqetësimet për fshatrat e tyre ndërsa kjo ana praktike për të qeshur me projekte kjo nuk është në rregull. Ne mund që për secilin projekt që është kryer kur ka gabime të thirret ekzekutivi, fjala është për kanalizime sepse ka probleme më të mëdha, në mënyrë që bashkarisht t'i thirrmin operatorët që i kanë kry këto punë e të sanohet dëmi.

Për zhvillimiet që vijnë nga qendra nuk është inati për të thënë që Malisheva po ndërtohet siç është edhe ndërtimi i shkollës në qendër të Malishevës ashtu siç është edhe pjesa e dytë e tranzitit.

Për projektet që nuk kryhen siç duhet fajtor i bëjë të gjitha operatorët dhe grupet të cilët teknikisht e kanë pranuar projektin.

Kryetar, kam një kërkesë për shkollën e fshatit Bubavec e cila i ka të rregulluar të gjitha mirëpo e ka një oborr që nuk i përgjigjet asaj shkolle prandaj kërkoj që të investohet në infrastrukturën e oborrit të shkollës.

Hashim gjithëçka mund të thuash për ekzekutivin por votë me pare askush nuk jep në Kosovë.

Kryetar, kërkoj që nëse keni mundësi që ju t'i drejtoheni Ministrisë së Infrastrukturës që për autostradën në fshatin Mleqan të bëjnë diçka që qytetarët të kenë çasje për tokat e veta në anën tjetër nga vijnë tek ura nga ana e Kjeves.

Avdi Morina: Pershendetje për të gjithë! Përveç shqetësime të tilla që u ngritën këtu janë edhe shqetësimet tona ato që janë me vend po njëkohësisht duhet që t'ju gëzohemi së bashku edhe për puntë e mira siç janë edhe investimet nga qeveria lokale dhe qendrore siç është tranzititi, ndërtimi i shkollës fillore në Malishevë, menaxhimi i situatës së Etheve Hemorragjike, Parku i Biznesit i cili i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara ligjore, ndërtimi i sallës sportive në shkollën "Ibrahim Mazreku" etj. Ju uroj suksese të gjithë atyre që i gëzojnë këto projekte.

Kastriot Berisha: Pershendetje për të gjithë! Kërkoj nga opozita që ta formojmë një Komision që të dalim në terren dhe t'i verifikojmë projektet duke i thirrur edhe mediat dhe t'i bëjmë publike të gjitha.

Është e vërtetë që po vijnë nga qendra projekte biznesit shkon me nr. të banorëve, Parku në Drenas nuk është mbushur as 50% me pjesëmarrës nga krejt Kosova. E ju për të shpërlarë para, për tja marrë tokën liderit të juaj e për t'ja paguar nga 9€ në 900€

Shqetësimi im ka të bëjë me zebat në rrugë. Kërkoj që ne si Kuvend të nxjerrim një vendim që zebat të ngriten me standarde nga niveli i rrugës për sigurinë e këmbësorëve në rrugë.

Rrahim Morina: Jo Halil, debati jashtë rendit të ditës ka përfunduar. Kryetari e ka fjalën.

Halil Morina: Nuk jam për ta prishiur rendin Kryesues, por kam një shqetësim edhe unë si gjithë të tjerët. Po më vjen keq që po e marrë fjalën të ligjëshmre, por pa leje!

Shqetësimi im lidhet me punën mbrenda kësaj salle sepse kjo është për t'i zgjidhur problet jashtë sallës. Ora është 12 e ne ende nuk kemi hy në rendin e ditë. Debat i jashtë rendit të ditës zgjatë 30 min, jo 2 orë. Rregulloje këtë. Kryesuesi e lejon dikë gjysmë ore dikujt nuk ja jap fare fjalën. Merru me shkaqet që të mos kesh pasojat.

Kryetari-Ragip Begaj: Përshendetje për të gjithë! këtu është vendi për t'i dhënë mendimet, kontributin dhe shqetësimet tona, nuk është vendi i forcës, i arrogancës. Hajdeni ta përdorim mendjen për të mirën e vendit tonë!

Ishte kërkesë e Alban Mazrekut që të rregullohet rruga në hyrje të Malishevës nga Banja. Ajo ka ndodhur për mosmarrëveshjet e juaja që keni ju në Malishevë. Tenderi për atë çështje është i shpallur, kompania është e përzgjedhur por kemi pasur disa pengesa edhe pse është dashur nuk e kam përdorë policinë.

Raimonda, Drejtorja e Kulturës ju ka dhënë përgjigjie dhe nuk e di a ju ka ardhur por përgjigjia është lëshuar me 18.06.2019.

Florentinë, projektet nuk bëhen për parti politike por bëhen njëjtë për të gjithë qytetarët dhe e di që me kanalizimet ka probleme në të gjitha fshatrat dhe ne duhet që të ndajmë mjete për renovimin e tyre.

Ilaz, lokacionin mund ta ndani ju këtu për shoqatat e dalura nga lufta edhe une jam për dhe është mirë që së bashku të bëjmë diçka për ta.

Ilaz, sa i përketë Zenelit unë e kam bërë një marrëveshje me Halil Kastratin ku 5,000€ i jap ër një shtëpi e ai 20,000€ këtë marrëveshje e kemi bërë për 5 shtëpi. Zenelin e kam lut për ndërtimin e një nga këto 5 shtëvive, por ai nuk ka pranuar. Tani janë përzgjedhur familjet se ku do të ndërtohen disa shtëpi. 3 familje janë në Kërvasari, 1 një Kjevë, një në Gllubovc dhe 1 në Vermicë dhe tri familje hala nuk janë përzgjedhur sepse tjerat do t'i ndërtoj Halil Kastrati.

Alban Krasniqi kërkoj që të mos i përgjigjem dhe nuk do t'i përgjigjem.

Hidajete, sipas projektit kanë qenë të parapara 10 drita sa i përketë ndriçimit publik dhe ato janë vendos.

Në përgjithësi me ujin e pijes ka problem e gjithë Malisheva, problem ka edhe fshati im edhe pse nga aty vjen uji por është përgjegjësi e Hidroregjionit jo e jona, por sa të mundemi do kemi ndikim që kjo gjendje të përmirësohet.

Hamëz, Shkoza nuk ka mbetur pa investime, është ndërtuar shkolla e rej janë shtruar disa rrugë etj.

Ali në çdo organizim bëhen lëshime dhe s'ka përfekt askund sepse ka gjëra që nuk parashihen e që ndodhin aty për aty. Edhe në Ditën e Çlirim të Malishevës ka mundur të ketë ndonjë lëshim. Hajdeni në vitin e ardhshëm ta bëjmë një Komision së bashku e të merremi me detajt siç përmendet edhe mënyrën e ulje të musafirëve, ftesat etj.

Sa i përketë ndarjes së bursave ne e kemi pasur një Komision dhe një anëtarë të opozitës dhe mendoj që nuk ka pasur asnjë shkelje. Unë nuk kam ndikuar të asnjë rast punën ja kam besuar atij Komisioni.

Sa i përketë transportit për në shkollë Hashim ne i kemi përzgjedhur disa raste sociale dhe për këtë është përzgjedhur kompania për barten e tyre, paraja i jepet kompanisë dhe jo nxënësit. Kjo ka qenë me tender.

Sa i përketë investimeve po ju uroj edhe fillimin e shkollës fillore këtu në Malishevë, po ndërtohet një shkollë e mirë dhe moderne.

Rrahim Morina: Falemnderit Kryetar! Kalojmë në debatin për rendin e ditës. A shkojmë me deklarime të shefave të grupeve? Fillojmë me NISMA.

Sylë Dukolli: Ne NISMA jemi që të miratohet rendi i ditës në tërësi, ashtu siç është.

Alban Mazreku: Ne kërkojmë që pika e 5-të të largohet nga rendi i ditës pasi që është në organet e hetuesisë.

Valon Krasniqi: Gjithashtu edhe ne kërkojmë që pika e 5-të të hiqet nga rendi i ditës.

Alban Krasniqi: E para, në deklarimet jashtë rendit të ditës ne ngrisim çështje, bëjmë pyetje dhe përgjigjet nuk i douma këtu për këtu për të gjitha pyetjet sepse ka disa që duhet përgjigje me shkrim me argumentim. Jo si Kryetari që po na tregon muhabete këtu.

Edhe ne pajtohemi që pika e 5-të të hiqet nga rendi i ditës sepse rasti është në polici dhe ne nuk mund të bëjmë shkelje duke marrur vendime.

Hajdin Berisha: Pershendetje për të gjithë! Po lidhem tek pika e 5-të e rendit të ditës. Është seanca 4-ërt apo 5-të që kjo pikë hiqet nga rendi i ditës. Pse nuk po pranoni që kjo pikë të hyjë në rendin e ditës të diskutohet kjo temë? Shkolla është duke vazhduar të ndërtohet. Ne duhet ta diskutojmë këtë temë pastaj në fund merret vendimi për ose kundër.

Rrahim Morina: PDK-ja, LDK-ja dhe VV-ja kërkojnë që pika e 5-të të largohet nga rendi i ditës. Kush është për?

Sylë Dukolli: Ne jemi që kjo pikë të jetë në rendin e ditës sepse kjo pikë nuk duhet të largohet për disa lojëra të Kastriotit e të disa të tjerëve që ngrisin padi palidhje. Shkolla është për qytetarë e jo për inate politike. Nëse kjo pikë nuk hynë në rendin e ditës ne e lëshojmë sallën. (NISMA lëshon sallën)

Rrahim Morina: Shkojmë në pauzën e drekës, kthehemi në ora 13:20.

Pas pauzës kourrum kemi sepse jemi 16 të pranishëm dhe mund të vazhdojmë me seancën. Ne mbetem tek votimi. PDK-ja, LDK-ja dhe VV-ja kërkojnë që pika e 5-të të largohet nga rendi i ditës. Kush është për?

Për: 16 (uanimisht)

Kalojmë në votimin e rendit të ditës. Kush është për këtë rend ditë pas largimit të pikës së 5-të?

Për: 16 (uanimisht)

Kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 04/115 e dt: 17.06.2019 e parashtruar nga drejtori i Drejtorisë Ekonomi, Financa dhe Buxhet për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Malishevës 2020-2022. Drejtori nuk është këtu dhe e saboton punën e tij edhe pse e thirrem. Duhet ta largojmë nga rendi i ditës këtë pikë në mugesë të drejtorit. Shkojmë me deklarimet e shefave të grupeve

Alban Mazreku: Meqenëse drjtori e bojkoton këtë pikë edhe propozojmë që të largohet kjo pikë nga rendi i ditës.

Valon Krasniqi: Edhe ne pajtohem qe kjo pikë të largohet nga rendi i ditës pasi drejtori refuzoi të jetë këtu.

Hidajete Mazreku: Kjo pikë është shumë e rëndësishme por u refuzua nga drejtori edhe dje në Komitetin për Komunitet edhe sot dhe është përkeqardhje.

Kastriot Berisha: Edhe ne pajtohem qe të largohet kjo pikë nga rendi i dirës dhe është e turpshme kjo qe bëri drejtori.

Rrahim Morina: Me sa e di unë kjo më së largu me të 30-tin duhet të dorëzohet në Ministri dhe kjo është një përpjekje nga ana e drejtorit dhe i Kryetarit qe po i lejon qe të sillen në këtë formë. Në mungesë të ekzekutivit kjo pikë largohet nga rendi i ditës. Kush është për qe të shtyhet kjo pikë?

Për: unanimitet

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/203 e datës: 28.03.2019 e parashtruar nga Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të komunës. Kryetar i këtij komisioni është drejtori Bashkim Krasniqi por sot nuk është këtu. E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Mazreku: Sa i përket kësaj pike ne si Asamble e kemi nxjerrë një vendim të datës 07.02.2019. Edhe pse është marrur ky vendim i cili nuk është zbatuar asnjëherë. Kam një kërkesë si grup e besoj qe pajtohen edhe grupet tjera qe janë këtu qe të marrim një vendim për zbatueshmërinë e këtij vendimi qe është marrë më heret duke i dhënë afat veç një muaj. Nëse edhe këtë herë nuk zbatohet ky vendim i nxjerrë nga Asambleja atëherë ne mund të vazhdojmë me procedurat gjyqësore.

Rrahim Morina: Mbase po pajtoheni shkojmë në votim. Albani propozoi qe të zbatohet vendimi i mëherëshëm 07.02.2019, nr. 02/89 i jepet afat ekzekutiv 1 muaj për fillimin e zbatimit të këtij vendimi. Kush është për?

Për: Unanimitet (17)

Kalojmë në pikën e 3-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/281 e dt: 17.06.2019 e parashtruar nga drejtori i Drejtorsë së Administratës për miratimin e Draft-Rregullores për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare në Komunën e Malishevës. Deri tani K. e Malishevës nuk ka pasur një rregullore të tillë për përdorimin e automjeteve. Drejtori nuk është këtu për shkak shëndetësor. E hapi debatin.

Valon Krasniqi: Ne kërkojmë qe Kryesuesi i Kuvendit ta ketë në dispozicion automjetin 24 orë ashtu siç e ka edhe Kryetari.

Alban Mazreku: Te pika 3 e nenit të 5-të shkruan qe përdorimin 24 orë ta ketë edhe Nënkyetari i komunës. Mirëpo ne propozojmë qe kjo të hiqet e të mos e ketë këtë të drejtë Nënkyetari për veturën 24 orë, por kjo mund të bëhet me një vendim të veçantë nga Kryetari i Komunës.

Hidajete Mazreku: Pajtohem plotësisht me Albanin.

Kryesues kam vërjetje qe në këtë mandat qe jam unë veturat zyrtare shfrytëzohen veç për zyrtarët e komunës ndërsa për komiteti pothuajse fare. Shpesh herë ka raste qe ne si këshilltarë

komunal s'këm mundësi për shfrytëzimin e veturave dhe është mirë që ne me Kryesuesin ta kemi në dispozicion një veturë.

Rrahim Morina: Kemi disa propozime: Te neni 5, pika e 2, shkruan që Kryetari i Komunës ka të drejtë ta shfrytëzojë veturën 24 orë edhe ditëve të vikendit. Unë propozoj që këtu ti shtohet edhe Kryesuesi që ka të drejtë ta shfrytëzojë veturën 24 orë për qëllime zyrtare. Ndërsa pika e 3-të e këtij neni për Nënkryetarin të hiqet krejtë. Kush është për?

Për: unanimitisht

Me votim unanim miratohet edhe kjo rregullore.

Kalojmë në pikën e 4-ërt të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr. 01/526 e dt: 25.04.2019 për marrjen e vendimit për procedurë të mëtejme për caktimin e lokacionit për ndërtimin e "Pishinës Gjysmëolipike" në Komunën e Malishevës. E hapim debatin për këtë pikë.

Hashim Vrenezi: Sa i përket kësaj pike ne si grup propozojmë që kjo pishinë të ndërtohet në lokacionin të "Parku i Mirushës" sigurisht që institucioni kompetent do të sjellë kopjen e planit, fletën poseduese si dhe paramasën dhe paralogarinë me specifikacion për koston që do të kryhet në atë pjesë.

Hidajete Mazreku: Sa i përket kësaj pike në bazë të dokumentave që ka kanë sjellur për lokacionin në Banjë mendoj që është hapësirë e vogël dhe nuk mund t'i përmbush të gjitha kërkesat e një pishini gjysmëolipike. Mendoj si VV-je dhe si qytetare e Malishevës mendoj që nuk duhet që t'i prishet bukuria e ligjës së Banjës, prandaj është mirë që të mendojmë me vizion se ku do ta çojmë këtë pishinë.

Duke bërë hulumtim mendoj që uji i Banjës deri nga qendra e Malishevës shkon me ramje të lirë dhe mendoj që kjo pishinë është mirë që të ndërtohet në Malishevë.

Valon Krasniqi: Konsideroj që është i nevojshëm një konsultim dhe në emër të grupit kërkoj një pauzë të shkurtër që të marrim një vendim të përbashkët.

Kastriot Berisha: Edhe ne AAK-ja pajtohem me atë që tha Hashimi sepse hapësira është më e madhe në Mirushë dhe i poltëson shumë kushte.

Rrahim Morina: Edhe unë pajtohem që nuk ka hapësirë një Banjë për këtë Pishinë, por ma e kqejja është sepse këtu nuk kemi material të majftueshëm për këtë. Nuk e kemi projektin, hapësirën e kërkuar.

Propozoj që është mirë që ta obligojmë Urbanizmin që t'na sjellë disa vende që mund të ndërtohet kjo pishinë gjysmëolimpike dhe pastaj ta përcaktojmë lokacionin.

Behije Sertolli: Pershendetje për të gjithë! Kjo pikë kërkon më shumë konsultim, hulumtim. Ne nuk jemi kundër fshatit Banjë që të bëhen investime por është mirë që të investohet për të gjithë qytetarët e Komunës sonë. Është mirë të dalim për një pauzë të shkurtër që të konsultohemi.

Rrahim Morina: Shkojmë në një pauzë 5 minutëshe për konsultime. Pas pauzës fjalën e ka Albani që të deklarojë konsultimet.

Alban Mazreku: Realisht Kryesues kompromis nuk pati. Ishin dy propozime: te “Parku i Mirushës” dhe te Pallankat. Është mirë që të kërkojmë një plan të fizibilitetit nga Drejtoria e Urbanizmit me të gjitha specifikacionet dhe koston për këtë pishinë.

Rrahim Morina: Pra kjo mbetet që Urbanizmi ta bie planin e fizibilitetit për të dy vendet te “Parku i Mirushës” edhe te “Pallankat” afer Stadiumit dhe të verikohet që a shkon uji me ramie të lirë e pastaj të vendoset për njërin lokacion. Kush është për që kjo të mbetet për mbledhjen tjetër për gjerat që kërkuam?

Për: 14

Kundër: 2

Abstenim: 1

Pra kjo pikë mbetet për mbledhjen tjetër që të diskutohet.

Kalojmë në pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit të Integritetit të Komunës së Malishevës për vitin 2018-2020. E hapi debagtin për këtë pikë. Mbase s’ka diskutues kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

Kundër: 0

Abstenim: 1

Kalojmë në pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nr. 05/255 e dt: 06.06.2019 për iniciimin e procedurave për hartimin e hartës zonale të Komunës. Kam biseduar me të urbanizmit dhe ata kanë thënë që duhet të marrim vetëm iniciimin e procedurave e më pas ata merren me ato. Kush është për?

Për: unanimisht (18)

Kalojmë në pikën e 8-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit të Drejtorisë për Bujqësi për mbjelljet pranverore për vitin 2019. E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Ne projekt buxhet e patëm nda shumë për t’ju ndihmuar bujqëve e kjo nuk ka ndodhur dhe kjo fletë që është sjellë si raaport si dhe mungesa e drejtorit tregojnë që i tërë funksioni i tyre është në ndarjen e subvencioneve pa kriteret dhe kjo është për t’u shqetësuar. Mjetet që po ndahen në emër të bujqëve nuk janë duke shkuar në destinimin e caktuar.

Në bazë të këtyre të dhënave shihet që ka tejkalim në sipërfaqën e planifikuar në krahasim me atë të realizuar. Shihni shifrat në raport. Besoj që këto të dhëna tërsisht janë të pavërteta dhe nuk janë të bazuara në tregues real.

Ne duhet që t’i mbledhim të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me këtë temë, me këtë sektor dhe patjetër duhet të jetë një pikë e rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme kjo çështje, qoftë në një mbledhje të rregulltë apo të jashtëzakonshme.

Ne Kryesues mundemi që si Kuvend ta organizojmë një takim me fermerë, bujq dhe grupe të interesit ku do t’i diskutojmë të arriturat e deritanishme, problemet dhe çka mund të bëhet më tepër.

Ali Morina: Komiteti i Bujqësisë në mbledhjen e mbajtur më fillim të muajit qershor ju ka drejtuar Drejtorisë së Bujqësisë me një kërkesë që pjesë e shtabit të korrje-shirjeve të jetë edhe njëri nga anëtarët e këtij komiteti. Përgjigje komiteti nuk ka marrë dhe si gjithëherë është injoruar nga kjo drejtori.

Në këtë raport thuhet që janë 5 anëtarë në këtë shtab, por më shqetësesja është se është paraparë që në përbërjen e vetë të ketë persona me kontratë në vepër ndërsa nuk ka pas vend për anëtarin nga Komiteti për Bujqësi.

Shqetësuese në këtë raport është nurmi 3,045 hektarë nevojiten që të jenë 45 kumbanja, ndërsa janë 35 të regjistruara në territorin e Malishevës. Nga shtabi i korrje-shirjeve nuk është bërë sigurimi i ndonjë kumbanje nga kumunat fqinje sipas raportit përveç që e kanë cekur që ju duhen 10 apo 15 kumbanja.

Thuhet aty që, shtabi zgjedhor ka rekomanduar që shuma të jetë rreth 100€ për korrjen e 1 hektari. Ata është dashur të dalin me një çmim fiks jo rreth 100€ sepse mund ta kalojë këtë shumë apo më pak. Pra është dashur të jetë shuma fikse.

Rrahim Morina: Mbase s'ka diskutues të tjerë kalojmë në pikën e 9-të: Shqyrtimi i kërkesës nr. 02/347 e dt: 11.06.2019 për miratimin e Raportit për Përformancë Komunale për vitin 2018. E hapi debatin për këtë pikë.

Mbase s'ka diskutues, kush pro aprovimit të Raportit të Përformancës Komunale?

Për: 16

Kundër: 1

Abstenim: 0

Kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit për kompenzimin e tri pagave përcjellëse sipas kërkesës së KPF-së dhe marrja e vendimit për kompensimin e tyre. Ne kemi kërkuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Ekonomisë dhe Financave që t'na sjellin një pasqyrë se sa puntorë janë dhe sa është shuma totale e tyre. Fatkeqësisht ata nuk na janë përgjigjur përveç listës nga avokati i komunës ata të cilët kanë bërë padi në gjykatë për këtë çështje. Ne kemi kërkuar në KPF që të sjellin dokumente se nga cili projekt hiqen këto para që i fitojnë me gjykatë. Kjo çështje është e ndjeshme dhe e ndërlikuar dhe që e dëmton buxhetin e komunës. E hapi debatin për këtë pikë.

Nebih Bibaj: Ne atëherë me vendim i kemi ndarë afërsisht 115,000.00€ për këtë çështje. Ne duhet të kërkojmë nga ekzekutivi se ku i kanë lënë këto para e më pas të merremi vesh për këtë çështje. Me sa kam informacione 90% e atyre mësimdhënësve janë në procese gjyqësore. Me procese gjyqësore po dëmtohet buxheti komunal dhe është mirë që në fillim të dimë se ku janë shkuar ato 115,000.00€

Behije Sertolli: Sa i përket lëndëve që janë në procese gjyqësore për tri pagat përcjellëse nga pensionistët kërkoj që ato të realizohen në bazë të ligjit dhe të drejtave legjitime të punëtorëve. Ata të mos detyrohen të ngrisin padi në gjykate e pastaj me vendim të prerë nga gjykata të pagahen këto rroga.

Në bazë të nenit të 58, ku thesohet se Kryetari si organ ekzekutiv në qeverisjen e vet lokale e autorizon avokatin e vet që në seancën e parë të bëjë pajtim gjyqësor me palën që të mos bëjë shpenzime të mëdha. Pra kërkoj që t'ju paguhet këto paga të gjithë mësimdhënësve që kanë kontribuar bukur shumë për arsimin në përgjithësi.

Mundësia tjetër është të ndahet një linjë buxhetore, mirëpo kjo varet nga Ministria e Financave dhe nga Parlamenti i Kosovës.

Alban Mazreku: Një interpretim që e ka kthyer MAPL-ja, në fund të fletës thotë: ky vendim mund të prodhojë efekt juridik. Atëherë është mirë Kryesues që ju në emër të Asamblesë t'i drejtoheni kësaj Ministrie që t'na bëjë edhe një interpretim të kësaj fjalie.

Është fymje për mësimdhënësit të vrapojnë nëpër gjykata për një të drejtë që ju garanton ligji. Nëse gjykata vendos që të tërhiqen mjetet nga një projekt kapitale komunës së Malishevës, atëherë këto mjete mund të tërhiqen nga drejtoria në bazë të këtij vendimi që kemi marrur na.

Alban Krasniqi: Kryesues, propozoj që ju dhe shefat e grupeve politike që bashkarisht të shkojmë në Ministri për t'i definuar saktë, mënyrat, procedurat se si ne t'i inkuprojmë në buxhetin e këtij viti, e të vitit të ardhshëm planifikimin për paga përcjellëse dhe jubilarë.

Hidajete Mazreku: Sa i përket kësaj çështje edhe vjet e kemi diskutuar goxha shumë. Më vjen keq që Kryetari nuk është këtu sepse ai për këtë çështje duhet të angazhohet më shumë. Kryetari e ka atë zotësi që ta kryej këtë çështje pa shkuar në Ministri të Financave dhe mund ta kryej këtë çështje së bashku me avokatin në seancën e parë, por Kryetari po heziton. Për pagesën për këto paga janë dy forma: pajtimi gjyqësorë dhe linja buxhetore sepse kështu po veprohet në Skenderaj, Obiliq dhe në Fushë-Kosovë.

Rrahim Morina: Pas debatit, a mund ta rrumbullakësojmë këtë çështje kështu: Kryesuesi së bashku me shefat e grupeve të kërkojnë një takim me drejtorin e buxhetit në Ministrinë e Financave dhe ta sqarojnë këtë çështje deri në fund.

Kalojmë në pikën e 11-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit për Përgatitjen e Krirje-Shirjeve nga Drejtoria për Bujqësi. Që doni hapim debat që doni e shtyejmë në mungesë të drejtorit. Në rregull e shtyejmë.

Kalojmë në pikën e 12-të të rendit të ditës: Përgatitjet për pritjen e bashkatdhetarëve të Komunës së Malishevës. Kjo është e planifikuar si pikë me Planin e Punës por material s'kemi sepse Drejtoria e Kulturës nuk na ka sjellë asgjë. E hapi debatin për këtë pikë.

Valon Krasniqi: Konsideroj që bashkatdhetarët tanë janë kontribues në cilën do etapë pa kursyer asgjë. Ne si Komision i Diasporës dhe drejtoria e Kulturës duhet të anazhohemi që pritja e tyre të jetë madhështore.

Alban Mazreku: Ne me vendim të Asamblesë e patëm themeluar Komisionin për Diasporë dhe iniciimin e Rregullores për Javën e Diasporës. Me sa kam informacion ky komisioni asnjëherë nuk ka mbajtur takime dhe nuk ka zgjedhur stukturat e tij. Mendoj që nëse kishte funksionu komisioni do të organizoni diçka për diasporën sepse të gjithë e dimë kontributin e tyre. Prandaj kërkoj që ky komision të funksionalizohet sa më shpejtë.

Alban Krasniqi: Mendoj që janë disa struktura mbrenda komunale këtu që duhet të merren me çështjen e organizimit të pritjes së bashkatdhetarëve. Ardhja e bashkatdhetarëve krijon edhe një rritje ekonomike, të fluksit të dinamizmit të jetës, të shfrytëzimit të resursve që i kemi, rritje të shërbimeve që kërkojnë nga organeve komunale dhe shtrohet pyetja se sa jemi të përgatitur ne si komunë për t'u përballur me atë fluks? Sepse shërbimet komunale lëjnë shumë të dëshiruar, trafiku është i pamënaxhueshëm sepse duhet vëmendje dhe gatdëshmëri 24 orë për çdo lloj emergjence vendosja e E-kjoskës etj. ne sivjet jemi vonë për tërë këto përgatitje. Ne jemi të interesuar që t'i presim mërgimtarët si qytetarë të kësaj komune, si kontributdhënës të kësaj

komune që për aq kohë sa të rrinë t'ua bëjmë qëndrimin sa më të lehtë e dinjitoz jo vetëm me një pano me rrugë e më një koncert 2 ditor.

Kastriot Berisha: Nuk e di çka kemi për të shtuar këtu përderisa përsoni përgjegjës për këtë çështje e që e ka për obligim nuk është këtu. Fjala është për drejtoreshën. Jam i sigurtë që drejtoreshë Meda i vjen e sipas saj si të është ai gjithëçka është në rregull.

Luan Kryeziu: Kryesues kam vërejtje për ju sepse po shkelet Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal ku te nei 21 thuhet se: duhet të ndalohen ofendimet, përdorimi i gjërave të cilat e pengojnë punën e Kuvendit Komunal. Duke u nisur nga kjo fletë që është këtu e vënë në foltore po shoh që ka fjalë fyese, pra po shkelet Rregullorja.

Sa i përket pritjes së diasporës nuk e di se si ma mirë do të kishte prte se sa qeverisja lokale që ju bënë pritje atyre. Gjatë kësaj periudhe zhvillohen shumë aktivitete nga Komuna e Malishevës. Për mendimin tim më mirë është ta quanim “Viti i Diasporës”, jo “Java e Diasporës” sepse ata duhet të respektohen gjatë gjithë vitit dhe të priten mirë. E dëgjoj këtu shpesh Rregullore për Diasporën, mendoj që nuk është e nevojshme kjo përderi sa është Ligji për Diasporën dhe rregulloret që janë nxjerë nga Ministria e Diasporës e që i rregullojnë këto çështje.

Nebih Bibaj: Doja t'i tregoja Luanit se Diaspora respektohet duke ju siguruar parking, duhet t'u hiqen procedurat burokratike, me rrit orarin e punës në shërbime publike si në paisjen me dokumente etj. Veç në këtë formë ndihmohen ata.

Luan Kryeziu: Ju jeni dëshmitarë që për parking Kryetari e ka lëshuar vendin në oborrin e Komunës si shenjë mikpritje për Diasporën.

Hajdin Berisha: Kjo temë është shumë serioze dhe është mirë ta trajtojmë me seriozitet sepse kemi të bëjmë me qytetarët tanë që punojnë në botën e jashtme. E përmendi Luani që më shumë se 1 vit oborri i komunës lirohet vetëm për mërgimtarët për gjatë gjithë sezonës së tyre.

Albani e përmendi E-bankomatin dhe mendoj që është një procedurë që duhet të kryhet dhe të rregullohet edhe kjo sa më shpejtë dhe të na lejojë sistemin për dhënien e dokumenteve Ministria.

U përmend këtu edhe festivali “Oda e Llapushës” i cili ka marru karakter kombëtar tash më, por data e përcaktuar për mbajtjen e tij është në kohën e mërgimtarëve.

Ne jemi qeveri dhe ne kemi me i prit me gjithë sugjerimet e juaja dhe në formën më të mirë të mundshme.

Rrahim Morina: Pas këtij debati kalojmë në pikën e 13-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nr.02/303 e dt: 22.05.2019 e parashtruar nga Sindikata Komunale e arsimit Parauniversitar (SKAP) në Malishevë. Ata kanë bërë një kërkesë për një zyre dhe materialin e keni. E hapi debatin për këtë pikë.

Mirë po kërkon që edhe pika e 14-të e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nr. 02/305 e dt: 23.05.2019 e parashtruar nga përfaqësuesi i shoqatës “Shën Tereza” dega në Malishevë mbase ka natyrë të njëjtë të diskutohen të dyja njëherësh.

Ju po kërkon që të autorizohet Kryetari që të lidh marrëveshje me Sindikaten Komunale të Arsimit dhe me Shoqatën “Shën Tereza”. Kush është për?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim aprovohen kërkesa e Shoqiatës Komunale të Arsimit Parauniversitare dhe kërkesa e Shoqiatës “Shën Tereza” dega në Malishevë.

Kalojmë në pikën e 15-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/53 e dt: 17.05.2019 e parashtruar nga z. Rexhep S. Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. E hapi debatin për këtë pikë. Mbase po thoni që mungon një nënshkrim në materialet e juaj do ta gjejmë origjinalin që ta shohim. Deri sa të vie dokumentacioni kalojmë në pikën tjetër.

Kalojmë në pikën e 16-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/58 e dt: 27.05.2019 e parashtruar nga Z. Arsim S. Krasniqi nga fshati Tërpezë e Poshtme për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Unë jma konsultuar me Muharremin që këtë kërkesë ta çojmë në këshillim paraprak në Ministrinë e Pushtetit Lokal me gjithë dokumentacioni që ka e të kërkojmë sqarime rreth kësaj lënde. Kur neve t’na kthen përgjigje Ministria ne e sjellim këtu. Atëherë shkojmë në votim. Kush është për që kjo lëndë të shkojë në MAPL për këshillim paraprak?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 1

Kalojmë në pikën e 17-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/59 e dt: 28.05.2019 e parashtruar nga Z. Fadil Thaçi nga fshati Mirushë për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Kryesues ne kemi miratuar një Rregullore që kur njerëzit lypin me ba ndërrimin e destinimit duhet që Drejtoria e Urbanizmit duhet të vije me një shkresë të specifikuar në lidhje me pronën e pastaj ne të marrim vendim këtu.

Luan Kryeziu: Kryesues sa i përketë këtyre pikave për ndërrim destinim të tokës bujqësore ne asnjëherë nuk i kemi kundërshtuar këto kërkesa që kanë ardhur nga qytetarët e sidomos kur janë të kompletuara me dokumentacion si sot.

Fadil Thaçi e ka të paraqitur kërkesën në formën ma t’mirë të mundshme nuk e di pse sot po kërkon që të shtyhet kjo pikë. Kur gjithëcka po shihet këtu qartë.

Ali Morina: Është e vërtetë që të shefi ynë i grupit të dhënat nuk vërhen, por te asambleistët tjerë letërnjoftimi i zotëriut në fjalë vërehet qartë. Mendoj që është një gabim i administratës në përgatitjen e materialit dhe mendoj që duhet që kërkesa e tij të procedohet më tutje e të votohet.

Rrahim Morina: Atëherë shkojmë në votim. Kush është për që të miratohet kërkesa e Fadil Thaçit për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore?

Për: unanimisht (18)

Kalojmë në pikën e 18-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/60 e dt: 29.05.2019 e parashtruar nga Z. Jetfir Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. E hapi debatin për këtë pikë.

Mbase s’ka debatues e hedhim në votim kërkesën. Kushë është për që të miratohet kërkesa e z. Jetfir Mazreku për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore?

Për: unanimisht (18)

Alban Krasniqi: Për të gjitha këto raste për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore është mirë që t'u lëmë një mundësi që të flasim me Drejtorinë e Urbanizmit që mbrenda zonës që kërkojnë duhet ta saktësojnë saktë se tokë bujqësore dojnë ta kthejnë në ndërtimore sepse tash Ministria kërkon tatim për tokë ndërtimore e mund t'u kthej në barrë të papërballueshme për këta njerëz. Ata po e sjellin kërkesën për aq okë sa kanë jo veç pjesën ku duan të ndërtojnë.

Rrahim Morina: Ndoshta është mirë që të saktësohet edhe sipërfaqja aq sa ju duhet për ndërtim. Kalojmë në pikën e 19-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/61 e dt: 29.05.2019 e parashtruar nga z. Fehmi Kryeziu nga fshati Bubavec për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. E hapi debatin për këtë pikë.

Mbase s'ka debat e hedhi në votim këtë kërkesë. Kush është për që të miratohet kërkesa e z. Fehmi Kryeziu nga Bubaveci për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e 20-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/62 e dt: 05.06.2019 e parashtruar nga z. Halit Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore. E hapi debatin për këtë pikë.

Atëherë kush është për miratimin e kërkesës së z. Halit Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e 21-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/62 e dt: 20.06.2019 e parashtruar nga Z. Ali Feriz Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. E hapi debatin për këtë pikë.

Mbase s'ka debatues e hedhi në votim këtë kërkesë. Kush është për që të miratohet kërkesa e z. Ali Feriz Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën që e shtymë për plotësim të dokumentit. Tani ajo është e plotësuar është pika e 16-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 06/53 e dt: 17.05.2019 e parashtruar nga z. Rexhep S. Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. E hapi debatin për këtë pikë.

Mbase s'ka debatues shkojmë në votim. Kush është për që të miratohet kërkesa e z. Rexhep Mazreku nga Malisheva për ndërrim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e 22-të të rendit të ditës: Të ndryshme. E hapi debatin për këtë pikë.

Mbase s'ka diskutues me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur. Falemnderit për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në ora 16:05

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina